

18/9

60/2



BASHKIA
TIRANË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Mediat

Nr. _____ prot.

Tiranë, më __, __, 2021

Lënda: Kthim përgjigje.

Qendra "Res Publica"

Përfaqësuar nga Z. Dorian Matlija

Adresa: Blv "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.7 Tiranë dhe adresa elektronike e-mail:
gendra.respublika@gmail.com

Për dijeni:

Znj. Blerta Goxha

**Koordinatorë për të drejtën e informimit
BASHKIA TIRANË**

Adresa: Sheshi "Skënderbej", ndërtesa nr.2, Kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri

I nderuar Z. Matlija,

Referuar kërkesës tuaj për informacion, drejtuar Bashkisë Tiranë, datë 11.06.2021, Nr.Prot Q-12821, regjistruar në Agjencinë e Mbrojtjes së Konsumatorit institucion varësie e Bashkisë së Tiranës me Nr.277 Prot. datë 16.06.2021, po ju përgjigjemi sa më poshtë:

Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, ushtron detyrat dhe kompetencat funksionale bazuar në rregulloren e brendshme për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, miratuar me Vendimin Nr.4911/1, datë 31.01.2020 të Kryetarit të Bashkisë.

1- Në Klinikën Veterinare, ushtrojnë detyrat e tyre bazuar në Kreun I, pika 2 të VKM-së Nr.230, datë 20.03.2013, "Për Përcaktimin e Funksioneve, Detyrave Specifike dhe Standarteve të Shërbimit Veterinar të Qeverisjes Vendore", në të cilin parashikohet: "Njësitë

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" 1001, ish selia e PD – së, Kati 2, Tiranë, Shqipëri.
Tel: 042 274774. E-mail: konsumatori@tirana.al

e qeverisjes vendore marrin masa për plotësimin me mjekë veterinarë të organikës së strukturave të tyre veterinarë...”, Vendimin Nr.4911/1, datë 31.01.2020 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, rregullore e brendshme “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës”, një staf prej 26 (njëzetë e gjashtë) mjekë veterinarë të diplomuar si të tillë në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT), në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare me një eksperiencë pune nga 3 (tre) deri në 35 (tridhjetë e pesë) vjet, dhe 5 (pesë) punonjës shërbimi.

Të gjithë mjekët veterinarë janë të regjistruar në regjistrin kombëtar nga Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar dhe janë të pajisur me Çertifikatë për Ushtrim Profesionit, në përmbushje të konformiteteve ligjore dhe profesionale, sipas Ligjit nr.113/2015 për “Urdhër Profesional të Mjekut Veterinar”, Statutit të Urdhrit të Mjekut Veterinar, Kodit të Etikës Profesionale të Mjekut Veterinar, Ligjit nr.10 465, datë 29.9.2011 për “Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Ligjit nr.20081/2009 për “Liqencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”.

2- Ankesat e qytetarëve për të cilat Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, ka reaguar nëpërmjet mbledhjes së qenve dhe kryerjes së procedurave profilaktike e rilëshimit në habitatin e tyre, vijnë nëpërmjet adresave zyrtare konsumatori@tirana.al ose info@tirana.al, nga aplikacioni (Tirana ime) të Bashkisë së Tiranës, nga mesazhet private të qytetarëve në rrjetet sociale zyrtare të Kryetarit të Bashkisë, Faqeve të Bashkisë Tiranë dhe atyre të Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit. Në varësi të emergjencës që paraqet rast konkret na drejtohen në numrin e telefonit të vënë në dispozicion të ankesave të qytetarëve 042 274 774 ose na delegohen nga numri i gjelbër i Bashkisë së Tiranës 0800 0888. Gjithësej numri i ankesave për qentë, në vitin 2019 ka qenë 199 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë), për vitin 2020 ka qenë 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë), ndërsa për periudhën e gjysmës së vitit 2021, janë 59 (pesëdhjetë e nëntë) ankesa. Lidhur me ankesat dhe kërkesat e qytetarëve të ndryshëm për qenë endacakë, të cilët shfaqin shenja të sëmundjeve zoonotike apo shenja agresiviteti (kanë kafshuar qytetarë), zbatohet ligji Nr. 10 465, 29.9.2011 “Për shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, dhe VKM Nr.230, datë 20.03.2013, “Për Përcaktimin e Funksioneve, Detyrave Specifike dhe Standarteve të Shërbimit Veterinar të Qeverisjes Vendore”. Lidhur me ankesa nga banorë për praninë e qenve endacakë në territorin e tyre, qentë kapen nga skuadra, kontrollohen nga mjekët veterinarë në klinikë, dhe në shumicën e rasteve janë adoptuar nga kafshëdashësit, sipas procedurës së përcaktuar nga institucioni ynë. Gjithashtu, kryhet profilaksia vjetore për qenë të cilët janë sterilizuar dhe matrikulluar.

Ligji material në kërkesat e ankuesit, ashtu siç edhe ju mund ta keni të qartë, janë Ligji nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të cilët janë të lidhur pazgjidhshmërisht në interpretim të njëri – tjetrit. Gjithë legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, vë theksin në respektimin dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut e në veçanti të ruajtjes së jetës private, mbi bazën e të cilave, pika 1 e nenit 17 “Kufizime” të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në gërmëën “a” specifikon në mënyrë sanksionuese, se: “E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme,

proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: a) të drejtën për një jetë private..”. Kërkesa juaj ka të bëjë me të dhëna personale të subjekteve dhe nuk mund të vihet në dispozicion të kujtdo, përveç personit/subjektit që ka interes të drejtpërdrejtë me një çështje të caktuar.

3- Punonjësi ynë i shërbimit, në cilësinë e gjuetarit, siç ju kërkon ta quani, disponon leje mbajtje dhe përdorimi arme, me datë lëshimi 20.01.2013 nga organet kompetente.

4- Referuar Ligjit Nr. 10 465, 29.9.2011 “Për shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”; Kreut VI, pikës 1 të VKM-së Nr.230, datë 20.03.2013, “Për Përcaktimin e Funksioneve, Detyrave Specifike dhe Standarteve të Shërbimit Veterinar të Qeverisjes Vendore”, në të cilën parashikohet: *“Njësitë e qeverisjes vendore hartojnë programe pune të profilaksisë veterinare në lidhje me situatën epizootike të qenve dhe maceve të rrugës, si dhe programe për kontrollin dhe lëvizjen e tyre”, janë bërë kërkesat (për medikamente dhe pajisje veterinare) dhe alokimi i buxhetit dedikuar kësaj kompetence. Sa më sipër, referuar Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, realizohen edhe procedurat e parashikuara për këtë zë.*

❖ Për pjesën tjetër të kërkesave tuaja të shprehura, por për të cilat mendoni se nuk keni marrë informacionin e duhur, në pikat 1 dhe 2 të nenit 17 “Kufizime” të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, vendoset si kusht, se: “Pavarësisht nga sa parashikohet në këtë pikë, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij”, ndaj jeni të lutur të plotësoni këtë kriter kushtëzues.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Rudina Hoxha

